

KDU 94 (496.5) "1948/1953"

325.14 (=18) "1948/1953"

Prof. dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

**REFLEKTIMI I INFORMBYROSË NË VEPRIMTARINË E
EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË KOSOVË NË
VITET 1948-1953**

Rrethanat ndërkombëtare të krijuara gjatë Luftës Dytë Botërore dhe pas mbarimit të saj, si dhe vendimet e marra në konferenca e takime të ndryshme të niveleve të larta botërore si: Karta e Atlantikut, Konferenca e Teheranit, Jaltës e Moskës, ndikuan në përcaktimin e fateve dhe të ardhmen e kombeve, humbës apo fitues qofshin ato.

Aleatët e luftës antifashiste: Anglia, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik në shumë aspekte nuk pajtoheshin me ecuritë që planifikoheshin të bëhen pas përfundimit të luftës dhe ngadhënjimit mbi fashizmin. Ndasitë vëreheshin në ndarjen e zonave të interesit dhe në ideologjitë diametralisht të kundërta. Derisa anglo-amerikanët ishin mbrojtës të demokracive më të avancuara, Bashkimi Sovjetik mbronte dhe përhapte ideologjinë komuniste. Andaj përfundimi i Luftës së Dytë Botërore thelloi edhe më shumë ndarjet ndërmjet këtyre dy blloqeve.

Fërkimet e aleatëve u reflektuan edhe në shtetet tjera pjesëmarrëse të luftës antifashiste në Ballkan.

Për ta forcuar influencën, dy kampet bënë përpjekje të vazhdueshme dhe akuza të ndërsjella. Aleatët perëndimorë, duke i parë ambiciet e mëdha të Stalinit, vepruan menjëherë në parandalimin e zgjerimit të influencës të Bashkimi Sovjetik. Cherrilli kuptoi rrezikshmërinë e situatës për përhapjen e një komunizmi ndërkombëtar dhe në mars të vitit 1946 mbajti fjalimin e njohur në Fulton, Misisouri, në të cilin përdori termin Perdja e Hekurt për të cilësuar kufirin midis Evropës Lindore të kontrolluar nga Bashkimi Sovjetik dhe botës perëndimore. Fjalimi i Cherrillit (i njohur si antikomunist) një vit më vonë u pasua nga shpallja e Doktrinës Truman, e cila garantonte se vendet që ndodheshin përballë trusnisë komuniste do të gëzonin mbështetjen e Amerikës.¹ Edhe Plani Marshall, i shpallur në qershor të vitit 1947, padyshim vuri vulën e ndarjes ekonomike të Evropës, duke e prerë kontinentin në një Perëndim të begatë dhe në një Lindje përherë të mbetur prapa.

¹ Gabriel Partos, Bota që erdhi prej të ftohtit, Tiranë, 1995, fq.14.

Në kundërshtim të influencimit perëndimor, Moska në vitin 1947 themeloi Byronë Informative. Paraqitja e Byros Informative tronditi edhe vendet komuniste, që nuk e duronin tutelën e Bashkimit Sovjetik. Këto mosmarrëveshje u shfaqën edhe ndërmjet Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Mosmarrëveshjet e para ndërmjet Moskës dhe Beogradit u paraqitën rreth mundësisë për krijimin e Federatës Ballkanike, kur Stalini iu kundërvu Dimitrovit, duke vlerësuar se kjo nismë është e hershme. Gjatë Luftës Dytë Botërore, Jugosllavia, ndryshe nga Shqipëria ishte më afër aleatëve. Në Konferencën e Jaltës, Fuqitë e Mëdha njohën kufijtë e Jugosllavisë së para pushtimit nazi-fashist, që nënkuptonte se Kosova do të mbetej brenda saj². Mirëpo, Stalini qysh në Jaltë shprehu interesim për Shqipërinë për faktin se ajo kishte pozitë politiko-geografike për dominim në Ballkan.

Fërkimet e para ndërmjet Titos dhe Stalinit u zhvilluan nëpërmjet letrave. Stalini në letrën e parë, të 27 marsit 1948, kritikonte dhe nënçmonte PKJ-në. Ishte i shpejt reagimi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë më 13 prill të po atij viti. Në rrethanat e krijuara edhe në KQ të PKJ –së nuk u manifestua një unitet çfarë ishte pritur. Kjo u reflektua, kur dy anëtarë të KQ të PKJ, Andreja Hebrangu dhe Sreten Zhujoviqi nuk u pajtuan me qëndrimet e shfaqura, duke përfshirë edhe mendimet e Titos.³

Stalini, duke ndier frikën edhe të shteteve tjera të përfshira në Bllokun e Lindjes, urdhëroi që mbledhja vijuese e Byrosë Informative të mbahet më 20-28 qershor në Bukuresht. Kjo mbledhje kishte për qëllim të trajtonte qëndrimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj Byros Informative. Në ftesën që iu dërgua PKJ-së, u sugjerua që në mbledhje të merrte pjesë Tito. PKJ-ja dhe Titoja nuk i përfillën kërkesat e Stalinit. Në takimin e Bukureshtit nuk mori pjesë përfaqësuesi i Polonisë, Vlladimir Gomulka dhe Kryeministri i Bullgarisë Georgi Dimitrov.

Detyra e Byrosë Informative ishte koordinimi i veprimtarive të partive politike komuniste midis anëtarëve të saj. Kjo do të thotë se çdo vend i Evropës Lindore u transformua në një kopje identike të Bashkimit Sovjetik. Kjo influencë sovjetike u hetua edhe në Shqipëri e Jugosllavi, pjesë e së cilës ishte edhe Kosova e aneksuar. Derisa Shqipëria mbështeti Byronë Informative, Jugosllavia shfaqti shenja mosbindjeje ndaj urdhrave të Kremlinit. Tito manovronte ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Në kuadër të manovrimeve politike të tij ishte edhe përpjekja për formimin e një Federate Ballkanike me dominim të Beogradit. Në janar të vitit 1948, Tito deklaroi haptas se dëshironte një Federatë Ballkanike me pavarësi e barazi të kombeve “në kuadrin e parimeve të pranuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara”⁴

2 A.Cont „Jalta dhe ndarja e botës f.123.

3 Mahi Nesimi: Nexhat Agolli –Atdhetar i harruar. Tetovë, 2012 fq.139.

4 Historia Botërore. Vep. e cit.fq. 173.

Si rrjedhën punët deri te ky konstatim i Titos? Tito dhe klika e tij nuk donin ta ndanin Shqipërinë me asnjë shtet, pasi për këtë ishte pajtuar edhe Enver Hoxha me vizitën që i bëri Titos në Bled të Sllovenisë.⁵ Ideja për një konfederatë me Jugosllavinë kishte rrjedhë nga fundi i luftës. Shprehimisht mendohej që Kosova t'i takojë Shqipërisë në kuadër të një federate ballkanike. Nëse kjo nuk ndodhë atëherë çështja e bashkimit të Kosovës bie në ujë.⁶ Në Plenumin e VII të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Enver Hoxha miratoi kërkesën për hyrjen e Shqipërisë në Federatën Ballkanike. Nisur nga ky vendim dhe duke shfrytëzuar edhe rrethanat që mbretëronin në Ballkan, Jugosllavia intensifikoi përpjekjet për krijimin sa më të shpejt të Federatës Ballkanike. Për këtë qëllim misionari jugosllav në Shqipëri, Savo Zllatiq kishte marrë direktivë, që t'i propozonte Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë planin e Titos që Shqipëria t'i bashkëngjitej Jugosllavisë, sipas parimit federal. Madje, ky propozim përfshinte edhe njësimin e forcave të armatosura me një komandë të përbashkët. Në fazën tjetër do të shqyrtohej edhe mundësia për një shtet të përbashkët, që do të paraqitej para opinionit "si dëshirë e popullit dhe e partisë"⁷, skenar ky ogurzi që përkujton aneksimin e dhunshëm të Kosovës nga Serbia në Konferencën e Prizrenit, në korrik 1945.

Enveri më parë dëboi nga Shqipëria të gjithë ata që ishin kundër Jugosllavisë, nacionalistët me të devotshëm kosovarë, që luftonin për bashkim kombëtar si Bedri Pejanin, Halim Spahiun, Qazim Komanin, e shumë të tjerë. Me këtë veprim, Shqipëria mbështeti politikën komuniste jugosllave, duke e ngushtuar kështu veprimtarinë e nacionalistëve shqiptarë që angazhoheshin për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Në fillim të vitit 1948 përpjekjet e udhëheqjes jugosllave për të shpejtuar procesin e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, u bënë edhe më intensive. Fatbardhësisht ky skenar i Titos për një federatë ballkanike me të cilin do të gllabërohej Shqipëria, nuk u realizua edhe për shkakun se BRSS nuk ishte e interesuar që Shqipëria të jetë e mbikëqyrur nga Jugosllavia. Madje, vetë Stalini dha urdhër për prishjen e Federatës, duke synuar t'i ruante pozitat e favorshme në Ballkan.

⁵ Prof Dr. Vehbi Xhemali, Falsifikimi i historisë kombëtare për hir të bashkim- vllaznimit me jugosllavët, "Bota Sot", 1 Qershor, 2011 f.18.

⁶ Agim Zogaj, Fuqia e ideve, Kosova në intervista, Zëri, 1993, Intervistë e Milovan Gjillasit, dhënë "Zerit", 1991

⁷ Punim i cit, "Bota Sot", qershor 2011 f.18

Organizimi i emigrantëve shqiptarë në Jugosllavi për rrëzimin e Enverit

Qeveria e Beogradit dhe ajo e Tiranës, pas paraqitjes së Byrosë Informative, filluan propagandën intensive për mospërkrahjen, përkatësisht përkrashjen e Byrosë Informative.

Shqipëria si përkrahëse e Byrosë Informative u lidh me Bashkimin Sovjetik, duke i bartur edhe pasojat e kësaj lidhjeje. Derisa Tirana zyrtare bënte propagandë intensive për të tërhequr popullin shqiptar të Kosovës në rrugën revolucionare marksiste-leniniste, duke e ushqyer me dashurinë për Informbyronë, Qeveria jugosllave ngrinte gjyqe kundër atyre që përkrahnin politikën e Moskës e të Tiranës.

Në këto rrethana marrëdhëniet e mira qysh nga koha e luftës me Jugosllavinë u keqësuan. Kjo u hetua qysh në fillim të vitit 1947, kur grupi intelektual brenda Frontit Demokratik nuk pranoi që Shqipëria të binte në pozitë skllavëruese ndaj Jugosllavisë.⁸

Tito angazhohej ta mbante të izoluar Shqipërinë nga perëndimi, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta kishte nën kontrollin e vet. Në anën tjetër, ai vetë kishte vendosur marrëdhënie diplomatike me SHBA-të.⁹ Njëkohësisht luftonte çdo përpjekje të shqiptarëve të Kosovës për realizimin e synimeve kombëtare. Keqësimi i marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, padyshim ndikoi edhe në politikën jugosllave ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe vendet tjera të mbetura në ish Jugosllavi. Ky regjim ndërmori masa të dhunës së përhershme mbi shqiptarët në emër të elementit “armiqësor” informbyroist.

Fushata e organizuar shtetërore antishqiptare mori hov, sidomos pas Rezolutës së Byrosë Informative (qershor 1948) me ç’rast Jugosllavia, përkatësisht Partia Komuniste e Jugosllavisë u shkëput nga Bashkimi Sovjetik. Pas këtij akti, u burgosën dhe u dënuan me burgime të rënda 436 shqiptarë, të etiketuar si informbyroistë.¹⁰

Në kuadër të kësaj politike ndëshkuese, më 1948 u organizua procesi i quajtur “informbyroistë” dhe filloi arrestimi dhe burgosja në masë e intelektualëve shqiptarë, shumica prej tyre në burgun famëkeq të Goli Otokut në Dalmaci. Shqiptarët për qeverinë komuniste jugosllave konsideroheshin “rrezik” i vazhdueshëm për interesat e tyre shtetërore.

Rrethanat në Ballkan ishin tejet të disfavorshme për Shqipërinë. Kufiri shqiptar ishte bërë arenë e provokimeve të shkaktuara nga shtetet fqinje për qëllimet e tyre agresive apo pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë.¹¹

⁸ Valentina Duka, Historia e Shqipërisë 1912-2000, Tiranë, 2007, fq.238.

⁹ Valentina Duka, vep.e cit. fq.244.

¹⁰ Prof.Dr.Emine Bakalli, Kosova gjatë viteve 1945-1997. Armët gjatë shekujve XIX-XX, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, 2005, fq.52.

¹¹ Internet, Matilda Arapi, Shqiptarët nuk ngurrojnë të fajësojnë Beogradin e Washingtonin për provokacione, Gazeta “Albania”, 2 shkurt 2008.

Vetëm gjatë vitit 1949 në kufijtë shqiptarë u shënuan 747 provokacione të llojeve të ndryshme tokësore, ajrore, detare.¹²

Në vitin 1949 raportet e Shqipërisë me fqinjët grekë dhe jugosllavë ishin të tensionuara.¹³ Grekët kishin krijuar disa çeta me verioepiroetë, duke shtypur traktate dhe duke i shpërndarë në Shqipëri për një kryengritje popullore në emër të një nacionalizmi antikomunist.¹⁴ Komitete të ngjashme u formuan edhe në Kosovë.¹⁵

Në anën tjetër, Bashkimi Sovjetik, kërkonte ta ndëshkonte Jugosllavinë për mosrespektimin e Kominformit (Kominterni), duke e futur në lojë veçmas Enver Hoxhën. Rreziku për një krizë ballkanike ishte evident. Ata që në Shqipëri e luftonin ndikimin dhe influencën sovjetike u dënuan, u pushkatuan dhe një pjesë e kaluan kufirin, duke menduar së do të gjenin strehim dhe përkrahjen jugosllave. Ndërsa për shqiptarët e Kosovës, Byroja Informative u bë shkak i burgosjeve dhe dënimeve të rënda, veçmas të intelektualëve nga ana e strukturave të pushtetit jugosllav, jo rrallë edhe pa gjyq, por edhe i arratisjeve të shpeshta në Shqipëri. Shqiptarët e Kosovës nuk mbështetnin Informbyronë, por shtetin shqiptar, sidomos pas tradhtisë që bën komunistët jugosllavë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kontekst duhet shikuar edhe valën e arratisjeve të shqiptarëve nga Kosova në Shqipëri si: Xhafer Vokshi, Shaban Braha, Shaban Haxhia, Ajet Haxhiu, Sali Shatri, Sali Kolgeci e shumë të tjerë. Në shumë raste të dy palët e pësuan keq, duke u futur në vallen e politikës së dy shteteve të armiqësuar. Jugosllavia u bë baza dhe streha kryesore e të arratisurve nga Shqipëria, që nuk e përkrahnin Byronë Informative.

Emigrantët në shërbim të politikës jugosllave

Në shërbim të politikës së tij dominuese në Ballkan pas dështimit të Federatës Ballkanike dhe paraqitjes së Byrosë Informative, Tito shfrytëzoi rrugë tjera të mundshme. Një vit pas shpalljes së Komitetit “Shqipëria e Lirë”, komunistët jugosllavë të armiqësuar me Moskën, pra edhe me Tiranën, mblodhën shqiptarët e ikur në Kosovë dhe shpallën “Komitetin për Çlirimin e Shqipërisë” nga zgjedha e Enver Hoxhës.¹⁶ U organizuan mjaft grupe diversantësh, që shpërndanë traktate në Shqipëri kundër Enver Hoxhës. Qëllimi ishte që Shqipëria të vihej nën ombrellën e Titos. Mirëpo, këto traktate, falë edhe propagandës që bënte “Balli Kombëtar”

¹² Po –aty.

¹³ Internet, Gazeta Albania, 2 shkurt 2008, marrë nga shkrimi i publikuar në “New York- Times”, 17 shtator 1949.

¹⁴ Gazeta “Flamuri” organ i Ballit Kombëtar, Romë, 15.VII 1957, fq.5

¹⁵ AK, Fondi: Shoqatat shqiptare në diasporë, ShBA, viti 1909-1992 K-nr.7.

¹⁶ Po aty, Gazeta “Flamur, organ i Ballit Kombëtar”, Romë, 1957. fq.3

në emigracion dhe brenda në Shqipëri, përfunduan në proje e vende tjera që ishin jashtë ndikimit në popull.¹⁷ Për të pasur përkrahjen edhe të emigrantëve të tjerë shqiptarë, të shpërndarë nëpër Evropë dhe botë, Tito dërgoi emisarët e vet në Siri, Turqi dhe Romë. Synimi ishte përgatitja e tyre kundër regjimit të Enver Hoxhës.¹⁸ Enveri ishte i njoftuar me organizimet e emigrantëve në Kosovë. Për këtë ai shprehej: "Titistët po bëjnë një propagandë të poshtër në Kosovë për të rekrutuar mercenarë, me të cilët mendojnë të kryejnë akte diversioni dhe sabotazhi në vendin tonë."¹⁹ Në këto vite akte diversante ndodhën nga të dyja anët.

Në Prizren, në maj të vitit 1951, u organizua një konferencë me të arratisurit politikë nga Shqipëria.²⁰ Konferenca kishte për qëllim krijimin e një "Shqipërie të pavarur e demokratike" dhe u bëri thirrje shqiptarëve, që ta përmbysin regjimin e Enver Hoxhës. Konferenca në Prizren u mbajt në konspiracion të plotë. Aty, sipas gazetës "Rilindja" morën pjesë afro 300 veta, kryesisht emigrantë nga Shqipëria, që kishin kaluar kufirin pas paraqitjes së Informbyrosë. Në këtë konferencë mori pjesë Dushan Mugosha ideator dhe kreator i këtij skenari albanofob, si dhe Kolë Shiroka përfaqësues i Frontit Popullor të Kosovës e Metohisë.²¹ Konferenca u mbajt në sallën e shtëpisë sindikale të kulturës. Sipas raportuesit të gazetës "Rilindja", salla ishte e stolisur me flamurin kombëtar, flamurin e RFPJ-së, fotografinë e Skënderbeut dhe të Titos.²² Konferenca u hap me duartrokitje frenetike për Shqipëri të lirë e demokratike me brohoritje për Titon, për vllaznim - bashkim, për Partinë Komuniste të Jugosllavisë etj. Konferencën e përshëndeti Fevzi Fishekçiu, sekretar i Këshillit Popullor të Qytetit të Prizrenit. Dushan Mugosha në cilësinë e organizatorit të kësaj Konference iu drejtua të pranishmëve me një fjalim nxitës.

"Me lejoni t'ju përshëndes në gjuhën shqipe, n'atë gjuhë që e kam përdorur në Shqipni gjatë kohës, kur kam luftua së bashku me shokët shqiptarë gjatë Luftës Nacional Çlirimtare. Historia e popullit shqiptar asht e mbushur me lufta. Që nga Skënderbeu e këndeje populli i Shqipnisë ka luftue shekuj me radhë. Në këto lufta ai ka tregu aftësi të jashtëzakonshme dhe se asht gati të luftojë deri në pikën e fundit të gjakut të vet për liri dhe pavarësi të tij".

Ai theksoi se në vitin 1941, me ndihmën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe të Titos, populli shqiptar rrëmbeu armët në luftë për liri

¹⁷ Po aty, fq.3.

¹⁸ Gazeta "Flamuri" organ i Ballit Kombëtar "195", fq.3.

¹⁹ Enver Hoxha, Vepra vëll. 6, 8 Nëntori,Tiranë, viti 1970 ,fq.478.

²⁰ Po aty, dhe "Rilindja", Prishtinë, 1951,fq.1.

²¹ Në Prizren u mbajt konferenca e emigrantëve politikë shqiptarë."Rilindja" Prishtinë, Maj 1951, f. 1.

²² Rilindja" nr 42 vit VII Në Prizren u mbajt konferenca e emigrantëve politikë të Shqipërisë, 31 maj 1951 f.1.

dhe pavarësi²³, duke shtuar se “Jugosllavia e kishte ndihmuar Shqipërinë në shumë aspekte në fushën ekonomike dhe politike”. Për keqësimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Mugosha fajëson ekskluzivisht Stalinin dhe politikën e tij grabitqare e plaçkitëse ndaj Shqipërisë, duke cekur se “Bashkimit Sovjetik nuk i ka shkua për shtati dhe për hesap zhvillimi i këso marrëdhëniesh”. Duke folur për pasojat e kësaj politike ai tha se “kjo politikë u ka dhanë kurajo disa reaksionarëve prej Perëndimit që të luftojnë për pozitat e humbura në Shqipëri, për robnimin e Shqipërisë.”²⁴

Ai bëri apel për nevojën e bashkimit të fortë ndërmjet shqiptarëve për një Shqipëri të lirë e të pavarur.

Dushan Mugosha nuk kurseu akuza kundër politikës së Enver Hoxhës që sipas tij “e ka nda popullin shqiptar prej popujve të Jugosllavisë dhe se Shqipëria sipas tij, e ka humb pavarësinë e vet në saje të politikës së Enver Hoxhës.”²⁵

Mugosha asnjëherë nuk përmendi se Jugosllavia kishte bërë ndarje cezarike të shqiptarëve, duke e shkëputur Kosovën dhe pjesët tjera në Maqedoni e Mal të Zi nga trangu etnik.

Në konferencë foli edhe Kolë Shiroka . Ai veç tjerash, theksoi: “Na vjen keq që ata që sundojnë sod në Shqipëri janë bisht i hegjemonisë së Moskës dhe me politikën e tyre antipopullore e kanë prurë Shqipërinë në gjendje shumë të vështirë.” Shqetësimi i tij ishte edhe interesimi i anglo-amerikanëve për Shqipërinë, duke thënë : “ ...Ne sod po shohim që në saje të kësaj politike të E.Hoxhes në vendet tjera, trathtarët e popullit shqiptar të përkrahur nga imperialistët të vendeve kapitaliste bajnë manovra ta shesin Shqipërinë interesave të huaja, ashtu si ka ba klika e Enverit”²⁶

Në vazhdim të konferencës u paraqit referati mbi situatën politike në Shqipëri .”Qëllimi i Qeverisë së Bashkimit Sovjetik ka qenë që kërkonte ta izolonte Shqipërinë”, thuhet në referatin e mbajtur në këtë konferencë. Këtë e justifikon fakti se “Qeveria e Bashkimit Sovjetik nuk ka me Shqipërinë asnjë akt mbi bashkëpunimin ndërkombëtar, bile nuk ka as ndonjë marrëveshje miqësie as të ndihmës reciproke, edhe pse këto marrëveshje i ka lidhur me shtetet e tjera që janë nën dominimin e saj”. Referati përfshiu edhe krimet e Enverit ndaj të gjithë atyre që nuk pajtoheshin me politikën e tij. Në konferencë diskutuan afro 20 veta²⁷. Në këtë tubim u formua Bashkimi i Emigrantëve Politikë të Shqipërisë dhe u aprovua programi që përfshinte këto pika:

23 Po aty f.2.

24 Po aty f.2.

25 “Rilindja”, 31 maj, 1951 artikull i cit f.2

26 Po aty .fq.2-3.

27 “Rilindja” maj 1951, artikull i cit fq.3.

1. Luftë kundër Enver Hoxhës dhe klikës së tij, luftë kundër nënshtrimit politik dhe ekonomik të Shqipnisë prej Bashkimit Sovjetik,
2. Luftë kundër pretendimeve okupuese të jashtme ndaj Shqipnisë dhe kundër tradhtarëve, të cilët Shqipninë ua shesin të huajve ,
3. Bashkimi i të gjitha fuqive në Shqipni dhe n'emigrim në luftë për republikë demokratike, të pavarur dhe të pandame të Shqipnisë.
4. Miqësi me të gjitha vendet që e respektojnë pavarësinë e Shqipnisë, në radhë të parë me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë, mikun e sinqertë të Shqipnisë.

Konferenca e emigrantëve shqiptarë në fund të punimeve të veta zgjodhi edhe udhëheqësinë e organizatës, e cila u drejtoi shqiptarëve në Shqipëri dhe në emigrim thirrjen për "Luftë për një Shqipëri të Lirë, të pavarur, të pandame, demokratike dhe republikane". Po ashtu, nga kjo mbledhje iu dërgua telegram përshëndetës Marshallit Tito dhe Miladin Popoviqit. Konferenca përfundoi me leximin e disa telegrameve që kishin arritur nga grupe emigrantësh të Shqipërisë nga Shkupi, Dibra, Shtipi, Gjorgje Petrov, ku i dëshironin punë të mbarë Konferencës dhe shprehnin gatishmëri për zbatimin e vendimeve që do t'i aprovojë ajo.

Organizatorët e kësaj konference dolën edhe me një pamflet politik me titull: "Thirrje shqiptarëve n'atdhe dhe n'emigrim."²⁸ Ky pamflet nga grupe diversantësh, shpërndahej në Shqipëri dhe Kosovë.²⁹

Veç tjerash, në këtë pamflet, thuhej: "Enver Hoxha e shiti pavarësinë e Shqipnisë në duar të Bashkimit Sovjetik, dhe se kjo qeveri sipas udhëzimeve të BRSS-së, ka bërë çmos për ta lënë popullin tonë pa mbështetjen e fuqishme, ajo ka shkëputur të gjitha marrëdhëniet me të vetmin mik të sinqertë të popullit të Shqipnisë, me RFPJ-në, me të cilët kemi luftue krah për krah gjatë LDB-së dhe na kanë ndihmue vllaznisht si në luftë ashtu edhe pas lufte."

Emisarët jugosllavë, që përgatitën dhe udhëheqin këtë organizim të emigrantëve shqiptarë, shkuan aq larg sa kërkohej që "liria dhe pavarësia e Shqipnisë të fitohej me luftë".

Mbledhjet dhe organizimet e emigrantëve shqiptarë në Jugosllavi përcillleshin me syqeltësi nga Dushan Mugosha, i cili ishte edhe ideator i këtyre organizimeve.

Organizata e emigrantëve politikë shqiptarë, shihte rrezikun edhe nga nacionalistët shqiptarë të degdisur nëpër Evropë, Turqi, Greqi e vende tjera, e që ishin bërë pjesë e misionit anglo-amerikan për rrëzimin e komunizmit në Shqipëri. Ata shpreheshin se "Qeveria e Enver Hoxhës, me politikën e vet, ka ba të mundur që elementët reaksionarë n'emigracion, bashkëpunëtorë të

²⁸ Rilindja, nr.42 viti.1951. Prishtinë.Thirrje shqiptarëve n' atdhe dhe n'emigrim
²⁹ Gazeta "Flamur" organ i Ballit Kombëtar. Romë 1957. fq.3.

okupatorit fashist, me ndihmën e disa qarqeve reaksionare imperialiste nga shtetet e jashtme, të çojnë krye, tue ba plane për shitjen e Shqipnisë dhe për kthimin e reaksionarëve të vjetër në pushtet”. Ata shkonin aq larg sa merrnin guximin të bëjnë thirrje në emër të popullit. “Populli i Shqipnisë ! “Atdheu ynë kurrë nuk ka qenë në situatë kaq te vështirë si sod. Kjo na ka detyru që të ju drejtohem në këtë mënyrë. Ne emigrantat politikë të Shqipnisë, të cilët e duem mbi të gjitha pavarsinë dhe nderin e popullit tonë, që kemi qenë të shtrënguem me u largue prej atdheut tonë e me gjetë strehë në Jugosllavinë vllaznore socialiste, me dhimbje ndëgjyjmë lajme mbi terrorin e pashembullt, që po bahet mbi ju, mbi vllaznit dhe motrat tona, mbi bababallarët dhe nanat toña, mbi mbarë popullin e Shqipnisë.” Në këto pamflete nuk mungonin as lavdatat për Jugosllavinë, si vend mik i Shqipërisë.

Këta emigrantë a thua nuk ishin në dijeni se kjo Jugosllavi komuniste kishte shtypur e masakruar shqiptarët e Kosovës, në luftën e Drenicës në Tivar e Dalmaci dhe në mënyrë më flagrante kishte mohuar të drejtën legjitime të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, të shprehur në Konferencën e Bujanit.

Të shtrënguar edhe nga pozita e emigrantit politik që në forma të ndryshme duhej t’i përshtatën politikës së shtetit ku merr azil, emigrantët shqiptarë shprehen ”na këtu me sy tanë jemi bind përsëri se popujt e Jugosllavisë, PKJ dhe shoku Tito kanë mbet si kanë qenë përpara, miqtë ma të mdhaj të popullit tonë, se ata duen mbi të gjitha me jetue në vllaznim e miqësi me popullin tonë, se ata janë për Republikë njëmend të lirë, te panvarun, të pandashme demokratike të Shqipnisë” (të pandashme nga Jugosllavia, sepse Tito planifikonte ta bënte republikën e shtatë- Shqipërinë.S.U.)...dhe mbi këtë bazë i drejtohem secilit shqiptar të ndershëm në qytet e katund, që të bashkohet në këtë luftë, sepse kjo asht e vetmja rrugë shpëtimi për popullin tonë të vogël dhe jemi të bindur se çdo shqiptar e ka vendin në frontin e luftës kundër tradhtisë, që ban klika e Enverit.” Ata shpreheshin se ky rebelim i tyre do të mbështetet nga Jugosllavia.³⁰ Jugosllavisë i konvenonte një Shqipëri destabilizuese, sepse e luhaste edhe ndikimin rus në këtë pjesë të Ballkanit. Megjithatë, edhe pse u zgjodh kryesia e organizatës së emigrantëve, askund në raportin e “Rilindjes” nuk thuhet emri i tij apo i strukturave që dolën nga kjo konferencë e emigrantëve politikë shqiptarë. U veprua kështu sepse pushtetarët e dinin mirë mllëfin që kishin shqiptarët e Kosovës ndaj politikës së kohës dhe kishte frikë nga reagimet e mundshme.

Këtë Konferencë e përcolli edhe Vehap Shita, në cilësinë e gazetarit të Radio Prishtinës. Sipas tij mbledhja ka qenë e organizuar në mënyrë shumë konspirative dhe është mbajtur në një lokal afër Urës së Gurit dhe atë në katin përdehës. Ai shprehet se nuk pajtohet me shkrimin e "Rilindjes" se në konferencë kanë marrë pjesë 300 veta, se kjo shifër është e fryrë nga vetë strukturat e shtetit, duke e zbritur shifrën në 100-150 veta dhe se delegatët kanë qenë me thirrje dhe se çdo gjë ka qenë shumë konspirative. Sipas tij, Dushan Mugosha ka qenë nismëtar dhe kreator i krejt këtij aktiviteti, dhe se, ka vendosur për rrjedhën e këtij organizimi. Qëllimi ka qenë që të formohet qeveria në ekzil. Në atë qeveri janë përfshirë edhe personalitete që në Kosovë kanë pas një reputacion si: Tajar Hatipi, një mësimdhënës i përkushtuar, dhe përgjegjës për arsim dhe Stathi Kostari, pastaj Lutfi Spahiu nga Luma³¹. Tajar Hatipi kishte dy mundësi, ta pranonte ofertën, ose për 24 orë ta lëshonte Kosovën. Në këtë organizim nuk ka pranua të jetë Mehmet Gjevori. Për këtë arsye shtëpia e tij ishte gjithnjë nën vëzhgim të UDB-së. Ai nuk dëshironte asnjë implikim politik, por ishte njeri që punonte shumë dhe puna e tij ishte e dukshme. Në këtë organizatë kanë marrë pjesë emigrantët që ishin kundërshtarë të Enver Hoxhës e që regjimi jugosllav i kohës i përdorte për interesat e veta politike.

Në vitin 1951 konsiderohej se 1000 refugjatë ishin arratisur nga Shqipëria në Jugosllavi.³² Qendra e emigrantëve politikë ishte Prishtina. Qeveria jugosllave kishte ofruar lehtësira speciale dhe ndihmë ekonomike për anëtarët e organizatës së emigrantëve të udhëhequr nga Apostol Tanefi. Sipas gazetës "Flamuri", organ i Ballit Kombëtar në Romë, që ishte kundër organizimeve të tilla qoftë në Greqi apo edhe Jugosllavi, thuhet se: "Apostol Tanefi i kishte deklaruar një korrespondenti frëng se nën urdhrat e tij ishin gati 50 000 luftëtarë për të marshua në Tiranë"³³ Kjo ishte një propagandë absurde për kohën, sepse asnjë shqiptar i Kosovës nuk iu bashkua Komitetit të Emigrantëve Shqiptarë në Prizren.

Emigrantët shqiptarë në Jugosllavi për të qenë përkrahës të politikës së kohës kishin edhe disa lehtësira. Shumica prej tyre ishin të punësuar dhe të sistemuar nëpër banesa. Kjo i detyronte në një farë forme të përfshiheshin në këto organizime. Shërbimet e specializuara përgatitnin individë apo grupe njerëzish për t'i çuar drejt Shqipërisë dhe kthyer prapa sërish me detyra të caktuara spiunazhi. Në këto veprime antishqiptare të organizuara nga strukturat e UDB-së, Dushan Mugosha bënte trysni te kadri arsimor shqiptar të ardhur nga Shqipëria, të bëhej pjesë e skenarëve të errët të Jugosllavisë për destabilizimin e Shqipërisë. Atyre iu ofroi dy

31 Deklaratë, Vehap Shita, gazetar, publisit dhe kritik i njohur nga Prishtina, dhënë më 20 prill 2011.

32 Internet. Skenari jugosllav për përmbysjen e Enver Hoxhës në vitin 1953, marrë nga Gazeta "The New York Times" më 29 mars 1953 e publikuar në Gazetën Albania, 12 shkurt 2008.

33 AK.Gazeta "Flamuri", organ Ballit kombëtar, 1957, fq.3.

mundësi, ta pranojnë ofertën e pushtetit dhe të bëhen pjesë e këtij skenari antikombëtar, ose për 24 orë ta lëshonin Kosovën. Kjo ishte forma më e mirë e dëbimit të kuadrit arsimor shqiptar në kohën kur shkolla shqipe në Kosovë kishte nevojë të madhe për kuadër shqiptar. Në këtë valë dëbimi, u përfshi edhe Sali Kolgeci, Selman Riza, Rexhep Krasniqi e shumë të tjerë.³⁴ Në vitin 1951, UDB-ja arriti që 128 mësime të tjerë të përjashtojë nga puna si të papërshtatshëm për sistemin e kohës.³⁵ Me gjithë përpjekjet për një organizim të emigrantëve shqiptarë, ky skenar nuk pati sukses.

Për këtë UDB-ja fajësonte mosangazhimin e duhur të Apostol Tanefit, i cili nuk kishte arritur, që brenda këtij komiteti të futën edhe shqiptarët nga Kosova. Të pakënaqur me Apostol Tanefin, UDB-ja zgjodhi përfaqësues të emigrantëve shqiptarë, Nik Sokolin.³⁶ Për t'i sensibilizuar edhe më tepër përpjekjet e tyre, UDB-ja përkrahi botimin e gazetës "Flamuri i Lirisë", organ i emigrantëve politikë nga Shqipëria³⁷. Kjo gazetë nuk doli më tepër se tre numra.

Gazeta që kishte formën e një pamfleti politik përfshinte të gjitha materialet e veprimtarisë së komitetit në fjalë. (Me gjithë përpjekjet tona për ta pasur në dorë këtë gazetë, ishte e pamundur të sigurohet në Kosovë. Arkivi i Kosovës dhe Biblioteka Universitare nuk e posedojnë në fondet e veta. S.U)

Këta emigrantë shkuan aq larg sa parakalonin nëpër rrugët e Prishtinës me parulla për rrëzimin e pushtetit në Shqipëri. Tubime e parakalime kishte edhe në Gjakovë, veçmas në hotelin "Liria", ku bëhej thirrje për përmbysjen e qeverisë së Enver Hoxhës.³⁸ Këto parakalime që ndillnin luftë nuk zgjatën shumë falë sugjerimeve të perëndimit. Interesimi i anglo-amerikanëve për rrjedhat në Jugosllavi, pra edhe në Kosovë, pati jehonë te shqiptarët e Kosovës dhe ata të Maqedonisë, por edhe te pushtetarët jugosllavë, të cilët kishin frikë për përsëritje të furishme të pakënaqësive të shqiptarëve të Kosovës, duke mos anashkaluar edhe ndikimin e opinionit ndërkombëtar, që vëzhgonte rrjedhat në Ballkan. Organizimi i emigrantëve politikë shqiptarë dhe strukturimi i tyre kundër Enver Hoxhës ka qenë në dobi të Titos pas paraqitjes së Informbyrosë dhe prishjes së marrëdhënieve me BRSS-në. Kjo formë e organizimit është menduar se do të këtë ndikim te shqiptarët e Kosovës. Dihet se çdo shtet bën kompromiset e veta të fshehta. Ky keqpërdorim i emigrantëve politikë shqiptarë nuk kishte të bënte vetëm me rrëzimin e pushtetit të Enver Hoxhës, por kishte për qëllim edhe përçarjen e shqiptarëve të Kosovës. Ishin disa faktorë që ndikuan

34 AK. Fondi KPK, Kutija-135 Dosjet e UDB-së për kuadrin arsimor 1945-1951.

35 Dr.Sulltane Ukaj, Kuadri arsimor. Vep. e cit. fq.259.

36 Deklaratë e Prof,Dr. Zekiria Cana, dhënë më 22.02.2008, Prishtinë.

37 Deklaratë e Zekeria Canes. dhënë më 20.05. 2008.

38 Z.Cana, 22.02.2008, Prishtinë.

në mosesuksin e këtij organizimi: Shqiptarët e Kosovës nuk iu bashkuan grupimeve të emigrantëve shqiptarë, pjesëmarrja e vogël e emigracionit jashtë Jugosllavisë, si dhe ndikimi dhe sugjerimi i aleatëve perëndimorë në politikën e Titos.

Këto ishin metodat që komunistët jugosllavë i përdornin si hakmarrje ndaj Shqipërisë për pozicionimin e saj ndaj BRSS-së. Provokime të rënda ndodhnin edhe në kufirin Shqipëri – Jugosllavi, që pasonin edhe me vrasjen e të dy palëve nga ushtria kufitare. Në një shkrim të gazetës “Rilindja” të datës, 30 gusht, 1951, jepet informatë se më 22 gusht organet qeveritare të Shqipërisë kanë hedhë një grup spiunësh, që kishin kaluar në Shqipëri pas Informbyrosë.³⁹ Një grup të tillë diversantësh shqiptarë i quajtur grupi “8 Nentori” kishte kaluar në Gjakovë më 17 shkurt 1952. Sipas raportit të këtij grupi diversantësh thuhet se “Në Kosovë nuk është vrejtur asnjë lëvizje ushtarake, përveç forcave që kanë qenë edhe më parë”, duke përfunduar se në “qytetin e Prizrenit dhe të Gjakovës ka një numër të vogël të arratisurish nga ato që UDB-ja përdor kundër vendit tonë”⁴⁰

Raste të tilla nuk ishin të rralla. Kalimi i kufirit për qëllim spiunazhi bëhej nga të dy anët. Gazeta “Zëri i Popullit” botoi një artikull ku përsëriste parullën e Moskës “se Jugosllavia në marrëveshje me shtetet e perëndimit është vatër e presionit agresiv kundër Shqipërisë”⁴¹ Me gjithë përpjekjet e strukturave jugosllave, veçmas UDB-së, këto organizime dështuan. Shqiptarët më nuk i besonin Titos dhe klikës së tij, i cili premtimet e luftës i kishte shkelur në mënyrën më flagrante.

Thënë shkurt as përpjekjet e Greqisë dhe as të Jugosllavisë nuk arritën me e rrëzua Enver Hoxhën .

Në vitin 1953 këto akuza të ndërsjella do të zbutën ca pas përmirësimit të marrëdhënieve sovjetiko-jugosllave dhe shqiptaro-jugosllave.

39 “Rilindja”. Edhe një krim i ri i informbyroistëve të Shqipërisë, 30 gusht 1951 fq.1.

40 Sabit Syla. Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës 1939-1981. Temë doktorati, Tiranë, 2011, fq.115.

41 Po aty – Rilindja, nr.43, 16 gusht 1951, fq.2.

Prof. dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

SUMMARY

**THE INFORMBIRO REFLECTION IN THE ACTIVITY OF
ALBANIAN EMIGRANTS IN KOSOVA DURING 1948-1953**

The break-up in relations between Yugoslavia and Albania following Information Bureau presentation influenced Yugoslav policy on Albanians in Kosova and other parts of Federation. This regime applied permanent violent measures against Albanians with so-called branding subversive informbiro elements. 436 Albanians, mostly intellectuals have been imprisoned and heavily sentenced after being branded as informbiroists. On the other hand, in Albania who ever resisted the influence of Soviets was sentenced or executed, with some who exiled across the border to Yugoslavia expecting to find shelter and support. Yugoslavia after 1948 became safe haven of escapees from Albania. Yugoslav communists alienated with Moscow and Tirana, sheltered Albanian fugitives in Kosova and declared the Committee for Liberation of Albania from Enver Hoxha's regime. In this spirit a conference of political fugitives from Albania was organized in Prizren in 1951. This organization established the Union of Political Emigrants of Albania and adopted a program aiming to oust Enver Hoxha from the power.

Yugoslavia preferred a destabilized Albania in order to shake Russian influence in the region of Balkans. However, these efforts did not succeed as several factors contributed to the failure of this organization. Kosova Albanians did not join to the groups of Albanian immigrants, as well as the influence and suggestion of the Western allies, especially the United States in Tito's policy.